



V E N D I M

I Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme / Ortaku i Vetem i Shoqerise "MALIDO" Sh.p.k.

Ne Tirane, sot date 17 maj 2011 (dymije e njembdhjete), dite e marte, Ora 18⁰⁰, para meje Noteres Alma I. POSHI, Anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne adresen: Rr. "Sulejman Delvina", Nr. 57, kt. 2 prane Hotel "Diplomat", u paraqit personalisht:

Gjovalin PRENGA, i biri i Gjunit, lindur me 07 qershor 1960 ne Mirdite, banues ne Tirane, mbajtes i dokument identifikimi Leternjofim ID nr. personal G00607072J, me cilesine e **Ortakut te Vetem te Shoqerise "MALIDO" shpk** ("Shoqeria"), person juridik i regjistruar me NIPT: K38707048Q, i cili me kerkoj per te qenc e pranishme ne mbledhjen e asamblese se ortakeve/ortaku i vetem te shoqerise se lartpermendur, e cila bazuar ne nenin 230 pika 2 te Ligjit Nr. 9901 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" eshte thirrur sot, ne kete vend dhe ore per te diskutuar dhe per te vendosur mbi rendin e dites si me poshte vijon:


1. Perditesimi i Statutit te Shoqerise "MALIDO" shpk, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
 2. Regjistrimin e Vendimit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR);
- Ortaku i Vetem pasi mori ne shqyrtim pikat e rendit te dites,

V E N D O S I:

1. Te miratoje perditesimet e Statutit te Shoqerise "MALIDO" shpk, me ndryshimet e ndodhura dhe ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" sipas Statutit qe i bashkangjitet ketij vendimi.
2. Depozitimimin e ketij Vendimi me Statutin bashkangjitur prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR).

Ne mungese te ceshtjeve te tjera per t'u shqyrtuar, mbledhja e asamblese/ortakut te vetem mbyllet ne oren 19⁰⁰.

ORTAKU I VETEM



Gjovalin PRENGA



Ky Vendim pasi u redaktua prej meje noteres, ju lexua me ze te larte dhe qarte Ortakut te Vetem te lartpermendur, i cili me deklaroi se vendimi dhe statuti bashkangjitur shpreh vullnetin e tij te lire e te plote duke e nenshkruar ate rregullisht para meje noteres.

Une Noteri duke e gjetur konform ligjit bej legalizimin e nenshkrimet bazuar ne nenin 39/c te Ligjit "Per Noterine".

NOTERE





STATUTI

I SHOQERISE "MALIDO" SHPK

Themeluesi qe nenshkruan me poshte:

Gjovalin PRENGA, i biri i Gjonit, lindur me 07 qershor 1960 ne Mirdite, banues ne Tirane, mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. personal G00607072J, qe ne vijim do te quhet "**Ortak**", sot me date 17 maj 2011, bazuar ne vullnetin e tij te lire, ne perputhje me Ligjin nr. 9901 date 14.4.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" vendosi te hartoje kete Statut te Shoqerise, si vijon:

Kreu I

Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia,

Neni 1

Emërtimi dhe forma ligjore

- 1.1 Shoqëria emertohet: "**MALIDO**" SHPK.
- 1.2 Shoqëria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (SHPK) ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise

- 2.1 Shoqëria ka per objekt te veprimtarise se saj:
Investime ne fushen e hidroenergjetikes, import-eksport, tregti me shumice e pakice te mallrave te ndryshem, projektim, ndertim e mirembajtje te veprave industriale;
Bar, Restorant, Hoteleri;
Transport mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendit, per vete dhe per te trete.
Shoqëria mund të realizojë çdo llojë operacioni financiar apo tregtar, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, akt-marrveshje me palë të treta brënda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
- 2.2 Shoqëria me qellim te arritjes se objektivave te saj mund te marre persiper si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje ne fitime e pjesmarrje ne shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me objektin e saj.
- 2.3 Gjilhashtu, Shoqëria gjate aktivitetit te saj ka te drejte te perdore marken e vet tregtare, te beje marketingun e prodhimeve dhe sherbimeve te saj si ne vend ashtu edhe jashte tij.





STATUTI

Neni 3 *Selia e shoqerise*

- 3.1 Shoqeria e ka seline ne adresen: **Lezhe, Rreshen, prane ish-Ndermarrja Ndertimit**".
- 3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e dege ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Vetem/Asamblese se pergjithshme te ortakeve.

Neni 4 *Kohezgjatja*

- 4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 5 *Kapitali themeltar*

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 100.000,00 Leke.
- 5.2 Kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga ortaku i vetem.
- 5.3 Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100,00 (njeqind) pjese te barabarta, vlera nominale e te cilave eshte 1.000,00 leke secila.
- 5.4 Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte:
Z. Gjovalin PRENGA – 100,00 pjese, 100 % te kuotave.
- 5.5. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.
- 5.6 Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6 *Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit*

- 6.1 Kapitali themeltar, mund te ndryshohet me te gjitha menytrat dhe modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim.
- 6.2 I vetmi organ kompetent per te vendosur ndryshimin e kapitalit themeltar eshte Asambleja e Pergjithshme/Ortaku i Vetem sipas nenit 81 te Ligjit Nr. 9901 date 14.4.2008.

Neni 7 *Transferimi i pjeseve te kapitalit*

- 7.1 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne cdo menyre te parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE TE SHOQERISE

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Organet kryesore te Shoqerise jane dy: Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme dhe Administratori.
- 8.2 Ortaku i Vetem i Shoqerise ka te drejte te kryeje cdo lloj veprimi qe ligji i njeh Asamblese se Pergjithshme.
- 8.3 Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshitet e meposhtme:
- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - Ndryshimet e statutit;
 - Emcrimin e shkarkimin e administratoreve;
 - Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te cksperteve kontabel te autorizuar;
 - Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
 - Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te ortakut te vetem/asamblese;
 - Ushtron kontroll mbi aktivitetin e administratorit;
 - Per te gjitha ceshitet e tjera te parashikuara nga ligji apo statuti;
- Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshitet e parashikuara ne shkronjat "g" dhe "h" te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentave perkatese.
- Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme ka kompetence per ushtrimin e te gjitha tagrave te dhena nga Ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Menyra e thirrjes, mbledhja dhe regjistrimi i vendimeve behen sipas dispozitave te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 9

Administrimi dhe kompetencat

- 9.1 Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit i cili caktohet ne statut, nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet, me te drejte ripertesitje.
- 9.2 Administrator i shoqerise eshte **Z. Gjovalin PRENGA**.
- 9.3 Administratori ka te drejtat dhe detyrimet si me poshte vijon:
- kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme;
 - perfaqesoje shoqerine tregtare me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj;



STATUTI

- c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) përgatise dhe nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara Ortakut të Vetem/Asamblese së Përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohen në Ligjin Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportoje përpara Ortakut të Vetem/Asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyrat e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;

Neni 10

Përgjegjësitë

- 10.1 Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë dhe ortakëve për shkelje të ligjeve, të statutit si dhe për fajet kryera gjatë administrimit të tij.
- 10.2 Administratori gjatë kryerjes së detyrave përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer me mirebesim.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 11

Marredheniet ekonomiko - financiare

- 11.1 Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.
- 11.2 Bilanci Kontabel Vjetor miratohet nga Ortaku i Vetem/Asambleja e Përgjithshme, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante, etj.
- 11.3 Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të tjerëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakut/ortakëve të shoqërisë.
- 11.4 Humbjet e Shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 11.5 Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimoret vijues.
- 11.6 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.7 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i



STATUTI

autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

- 11.8 Shkarkimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.
- 11.9 Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne gjuhcn shqipe dhe ne monedhen shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecante ne valute.
- 11.10 Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga eksperti kontabel i autorizuar i cili mban pergjegjesi ligjore per punen e tij.

KREU V PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 12

- 12.1 Shoqeria do te hyje ne procedurat e likujdimit ne perputhje me Nenet 190 deri 205 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarct dhe shoqerite tregtare" nese:
- Ortaku i vetem/asambleja e pergjithshme vendos te prishe shoqerine;
 - Me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - Me vendim te Gjykates;
- 12.2 Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 (nje) apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likujdatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e sipër".
- 12.3 Afati i emerimit te likujdatorit publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 12.4 Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likujdimit.
- 12.5 Administratori regjistron prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Per qendren Kombetare te Regjistrimit". Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim.

KREU VI DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 13

Mosmarveshjet dhe ligji i aplikueshem

- 13.1 Çdo mosmarveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise midis shoqerise dhe te treteve, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat shqiptare



STATUTI

- 13.2 Çfare nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të rregullohet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.3.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe legjislacionit koherent.
- 13.3 Në rast se ndonjë nga nenet e këtij statuti do të jetë i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky nen nuk do të konsiderohet, ndërsa të gjitha nenet e tjera të këtij statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshëm.

Neni 14

- 14.1 Ky Statut redaktohet dhe nënshkruhet në katër kopje me përmbajtje dhe vlerë të njëjtte juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "MALIDO" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën origjinale.

ORTAKU I VETËM

Gjovalin Prenga

Gjovalin PRENGA



17.05.2011.